

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA



QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera
- Ministry of Finance, Labour and Transfers



INSPEKTORATI
QENDROR I PUNËS

Inspektorati Qendror i Punës/Centralna Inspektorat Rada/ Central Labour Inspectorate

INSPEKTORATI I PUNËS

02V- 102/25/1427

Republika e Kosovës Republika Kosova / Republic of Kosovo	
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera Ministry of Finance, Labour and Transfers	
Inspektorati Qendror i Punës Centralna Inspektorat Rada Central Labour Inspectorate	
Nr./Br./No. 102/25	Nr./Br./No. pg. 09
Data/Çelimi/Date 16.10.2025	
MITROVICË / MITROVICA / METROVICA	

Inspektorët e Punës në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve - të Inspektoratit Qendror të Punës, Divizioni në Rajonin e Mitrovicës, Inspektori [REDAKTUAR] të autorizuar me dispozitat e Nenit 83, 92 dhe 94 të Ligjit nr.03/L- 212 të Punës, dispozitës të nenit 1, 2 dhe 5 të Ligjit Nr. 2002/9 dhe Ligjit Nr.03/L-017, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës në Kosovë, procesverbal të inspektimit me nr. 02-102/25/1427 të datës 25.11.2025, procesverbal të riinspektimit me nr. 02-102/25/1427A të datës 24.12.2025, më datën 16.01.2026, merr këtë:

V E N D I M

Për shqiptimin e masës ndëshkimore

Subjekti juridik “Guard De Capital” Sh.p.k. me NUI 811409772 me seli në: Njësia në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Komuna e Mitrovicës, me pronar [REDAKTUAR] (në tekstin në vijim punëdhënësi) konstatoam këtë gjendje faktike:

- Cenimin e dispozites së nenit 10, i Ligjit Nr.03/L-212 i Punës, e sanksionuar me dispozitat e nenit 7 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2012 Për Përcaktimin e Gjobave dhe Shumave Konkrete për shkelje të dispozitave të Ligjit të punës, i shqiptohet gjoba ne shumë prej: **NJËQIND (100) Euro.**
- Cenimin e dispozites së nenit 20, i Ligjit Nr.03/L-212 i Punës, e sanksionuar me dispozitat e nenit 7 paragrafi 2 nënparagrafi 2.12 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2012 Për Përcaktimin e Gjobave dhe Shumave Konkrete për shkelje të dispozitave të Ligjit të punës, i shqiptohet gjoba ne shumë prej: **DYQIND (200) Euro.**
- Cenimin e dispozites së nenit 71, i Ligjit Nr.03/L-212 i Punës, e sanksionuar me dispozitat e nenit 7 paragrafi 2 nënparagrafi 2.30 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2012 Për Përcaktimin e Gjobave dhe Shumave Konkrete për shkelje të dispozitave të Ligjit të punës, i shqiptohet gjoba ne shumë prej: **DYQIND (200) Euro.**

- Gjithsej ndaj Subjektit juridik "Guard De Capital" Sh.p.k. me NUI 811409772 me seli në: Njësia në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Komuna e Mitrovicës, me pronar [REDAKTUAR] i shqiptohet Gjoha në lartësi prej Pesëqind (500.00) Euro.

Dëftesa mbi pagesën e gjobës merrët në Inspektorat të Punës, adresa: Rr:"Afrim Zhitia" p.n. Mitrovicë, afati i pagesës 30 ditë.

Punëdhënësi duhet të dëshmoj pagesën e gjobës, duke dorëzuar një kopje të pagesës në zyrën e Inspektoratit të Punës, në Mitrovicë, rruga:"Afrim Zhitija", (Ndërtesa e ish Administratës Pensionale), kati i III-të, zyrja nr.06, në të kundërtën do të konsiderohet se nuk është bërë pagesa dhe do iniciohet procedura përmbarese tek organet kompetente.

A r s y e t i m

Më rastin e riinspektimit në subjektin e lartëcekur në bazë të inspektimit të bërë me datë 25.11.2025, lidhur me ankesën me nr. prot. 235/25 të datës 04.11.2025, nga pala ankuese [REDAKTUAR] ka bërë ankesë në Inspektoratin e Punës, lidhur me pretendimet se e njehta ka pasur kontrate deri me date 01.10.2025, dhe nuk është njoftuar për largim nga puna deri me datë 28.10.2025, pra e njehta pretendon se është larguar nga puna pasi që është shtatzënë. Gjatë inspektimit kemi obliguar të prezentoj dokumentacionin nga mërdhënia e punës, ku brenda afatit të dhënë me procesverbal 02-102/25/1427 të dt.25.11.2025, zyrtarët nga subjekti juridik kanë sjellë dokumentacionin e kërkuar në zyrët e Inspektoratit të Punës në Mitrovicë.

Punëdhënësit i është dhënë vërejtje në bazë të nenit 5.5 shkronja b) të Ligjit Nr.2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, që deri më datën 28.11.2025, të prezentoj këto dokumentacione:

Brenda afatit ligjor subjekti juridik, ka sjellur ne zyret e Inspektoratit të Punës në rajonin e Mitrovicës, këtë dokumentacion të evidentuar më poshtë.

- Dosjen e sjellur të punëtorit që ka bërë ankesë;
- Kontratën e punëtorit që ka bërë ankesë;
- Lista e pagave për 6 muajt e fundit;
- Listën e punëtorëve;

Nga lëmia e marrëdhënies së punës:

Punëdhënësi ka prezantuar dëshmitë se punëtori që ka bërë ankesë ka qenë i lajmëruar në (ATK).

Punëdhënësi ka prezantuar kontratën e punës për punëtorin që ka bërë ankesë, i obliguar me dispozitën e nenit 10 dhe 11 i Ligji nr.03/L-212 i Punës. Mirëpo punëtores [REDAKTUAR] ka skaduar kontrata e punës me datë 01.10.2025, dhe e njejta është mbajtur në punë edhe në muajin tetor pa kontratë të punës, në këtë rast punëdhënësi ka bërë shkelje të nenit 10, të Ligjit nr. 03/L-212 i Punës.

Punëdhënësi nuk ka prezentuar evidencën e hyrje-daljeve, i obliguar me dispozitën e nenit 20, të Ligjit nr. 03/L-212 i Punës. Në këtë rast ka bërë shkelje të nenit 20, të Ligjit nr. 03/L-212 i Punës.

Punëdhënësi ka sjellur listën e punëtorëve të cilët janë duke punuar në subjektin juridik.

Punëdhënësi nuk ka prezentuar dëshmi të njoftimit për ndërprerje të mardhënies së punës, konform nenit 71, par 2. të Ligjit nr.03/L-212 i Punës, ku (citojmë): “2. *Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës për kohë të caktuar me njoftim prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike. Punëdhënësi i cili nuk ka për qëllim të ripërtërijë kontratën me periudhë të caktuar duhet të informojë punësuarin së paku tridhjetë (30) ditë para skadimit të kontratës. Dështimi për ta njoftuar nga punëdhënësi, do t’i japë të drejtën të punësuarit për zgjatjen e tridhjetë (30) ditëve kalendarike shtesë me pagë të plotë.”. Në këtë rast është bërë shkelje e dispozitës së nenit 71, par.2 i Ligjit nr. 03/L-212 i Punës.*

Ndërsa lidhur me pretendimet nga pala ankuese se i është ndërprerë mardhënia e punës pasi që ka qenë shtatzënë nuk qëndrojnë pasi që, neni 53, Ligjit nr. 03/L-212 i Punës, ku (citojmë): “Gjatë kohës së shtatzënisë, pushimit të lehonisë dhe mungesës në punë për shkak të përklujdesjes së veçantë ndaj fëmijës, punëdhënësi nuk mund t’ia shkëpusë kontratën të punësuarit dhe t’ia ndërrojë vendin e punës, përveç në rastet e shkëputjes së kontratës sipas nenit 76 të këtij ligji”. Mirëpo mosvazhdimi i kontratës së punës nuk nënkupton shkëputje të mardhënies së punës, ku bazuar në nenin 67, ku (citojmë): “Ndërprerja e Kontratës së Punës sipas fuqisë ligjore 1. Kontrata e Punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet: 1.1. me vdekjen e të punësuarit; 1.2. me vdekjen e punëdhënësit, kur puna e kryer apo shërbimet e ofruara nga punëtori janë të natyrës personale, atëherë kur kontrata nuk mund të vazhdohet me pasardhësit e punëdhënësit; 1.3. me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës; 1.4. kur i punësuarit e mbush moshën e pensionimit, prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç; 1.5. në ditën e dorëzimit të aktvendimit të plotfuqishëm për vërtetimin e humbjes së aftësisë për punë; 1.6. nëse i punësuarit shkon në vuajtje të dënimit i cili do të zgjasë më tepër se gjashtë (6) muaj; 1.7. me vendimin e gjykatës kompetente, vendim që pason ndërprerjen e marrëdhënies së punës; 1.8. me falimentimin dhe likuidimin e ndërmarrjes; 1.9. rastet e tjera të përcaktuara sipas ligjeve në fuqi.”

Andaj duke u bazuar nga të dhënat e cekura më lartë u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Punëdhënësi është i obliguar, që në vazhdimësi të bëjë zbatimin e dispozitave të Ligjeve në fuqi, Ligji 03/L-212 të Punës dhe Ligji 04/L- 161 për Siguri dhe Shëndet në Punë, në të kundërtën

moszbatimi i dispozitave të këtyre ligjeve do të merren si masë rëndësuese dhe do të cilësoheni si recidivist.

Një kopje e këtij vendimi i dërgohet subjektit juridik "Guard De Capital" Sh.p.k. dhe kopjet tjera mbesin në Inspektoratin e Punës për procedura të mëtutjeshme.

Udhëzim juridik: Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankesë në afat prej 30 ditësh në Komisionin e Ankesave të MFPT-së, nëpërmes Inspektoratit të Punës në Mitrovicë, Rruga: "Afrim Zhitia", ish objekti i ndërtesës pensionale, kati i dytë, nr.34, Mitrovicë.

Data: 16.01.2026



Inspektorët e Punës

